



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 282, Datë 25.09.2023

MBI

ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K., PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK “TEKSOEN 1”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 2, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.09.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2033/9 prot., datë 21.09.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së bordit të ERE-s në lidhje me aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2033 prot., datë 16.08.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1”, me kapacitet të instaluar 2 MW dhe me vendimin nr. 255, datë 23.08.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.08.2023 dhe 25.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 02.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresat nr. 2033/3 prot., datë 07.09.2023, nr. 2033/4 prot., datë 12.09.2023 dhe nr. 2033/7, datë 19.09.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar respektivisht dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht prej saj.
- Në vijim shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2033/5, datë 12.09.2023, nr. 2033/6 prot., datë 15.09.2023 dhe me emailin protokolluar me nr. 2033/8 prot., datë 20.09.2023, ktheu përgjigje duke plotësuar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar.
- Vlefshmëria e licencave që ERE ka lëshuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike është bazuar në jetëgjatësinë e paneleve, për të cilën subjektet e kanë plotësuar aplikimin mbi dokumentacionin teknik/garancitë teknike (depozituar dokumentacioni vërtetues për shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. që referon këtë jetëgjatësi, e në vijim është përcaktuar afati i vlefshmërisë së licencës.
- Në nenin 14, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.
- Me qëllim komunikimin me shoqërinë për të sqaruar dokumentacionin teknik dhe arritjen në një përfundim se sa vite do të jetë licenca për këtë subjekt, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., duhet të depozitojë dokumentacionin teknik mbi të cilën e bazon jetëgjatësinë e centralit fotovoltaiik.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit mbi aplikimin e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Teksoen 1” me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në njësinë Administrative Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier.

2. Brenda 20 (njëzet) ditëve shoqëria “IDI 2005” sh.p.k., të depozitojë dokumentacionin teknik mbi të cilën e bazon jetëgjatësinë e centralit fotovoltaiik..
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI